



## NJOFTIM PËR POZICIONIN

### “Jurist/e / Specialist Prokurimesh”

*Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.*

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “Specialist Prokurimesh”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

### Detyrat e “Jurist/e / Specialist Prokurimesh”

Specialist i Prokurimeve, nën mbikqyrjen e Drejtorit të Projektit dhe Shefit të Financës, do të jetë përgjegjës për gjithë procesin e prokurimit në kuadër të projektit “Ekipe Sportive 2022”.

Për të përmbushur objektivat e caktuara Specialisti i Prokurimeve duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Oranizon të veprimtarinë e punës në sektorin e prokurimeve dhe raporton drejtpërdrejt te Drejtori i Projektit dhe Presidenti i KOKSH.
- Organizon punën në hartimin e dokumenteve të tenderit, duke kontrolluar ligjshmërinë e kërkesave të caktuara në to.
- Harton dosjen e tenderit. Duke përfshirë urdhërin e prokurimit dhe urdhërin për



ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe pas miratimit nga titullari i institucionit, merr masa për vënien në dispozicion të anëtarëve, të dokumenteve të tenderit për prokurimin që kryhet.

- Përgatit relacione dhe informacione periodike lidhur me mbarëvajtjen e punës dhe bën propozime konkrete për zgjidhjen e problemeve të hasura, duke respektuar legjislacionin në fuqi.
- Merr pjesë dhe monitoron përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, në rast kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme.
- Është përgjegjës për dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore lidhur me të gjitha procedurat e prokurimit.
- Është përgjegjës për të gjitha veprimet në sistemin online të APP.
- Me përfundimin e procedurave të tenderit, dorëzon dokumentacionin përkatës në arkivin e KOKSH, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga epërori.

**Kualifikimet dhe Eksperienca:**

- Të ketë përfunduar Fakultetin Ekonomik apo Juridik, DNP (Diplomë e nivelit të parë) + Master, ose DIND (Diplomë e integruar e nivelit të dytë);
- Të paktën 2 vite eksperiencë profesionale në fushën e prokurimeve publike;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.

**Aftësi dhe kompetenca kryesore**

- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese;
- Të ketë aftësi shumë të mira shkrim dhe arsyetim ligjor;
- Të zotrojnë në nivel shumë të mirë "Paketën Office";
- Aftësi bashkëpunuese në grup.



## Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 23 Shkurt, ora 16.00, në adresën [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al) , me subjekt: Aplikim për pozicionin “**Jurist/e / Specialist Prokurimesh**” “Ekipet Sportive 2022”.